

Në bazë të nenit 38 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 48/29) dhe nenin 187 të Statutit të Komunës së Ulqinit (" Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat e komunes", nr. 48/19) Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në seancën e mbajtur më 29.07. 2022, ka miratuar.

VENDIMI
PËR NISJEN E PROCEDURES PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
STATUTIT TË KOMUNËS SË ULQINIT

Neni 1

Me këtë vendim niset procedura për ndryshimin e Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi –dispozitat e komunes, nr.48/19)

Neni 2

Kuvendi i Komunës së Ulqinit me vendim të veçantë formon Grupin Punues, në të cilin marrin pjesë përfaqësues të klubeve të këshilltarëve, përfaqësues të pushtetit ekzekutiv dhe subjekte të tjera profesionale.

Neni 3

Grupi punues është i obliguar që në afat prej 60 ditësh të përgatisë versionin e drafrit punues të ndryshimeve të Statutit, në mënyrë që Këshilli për Statut dhe dispozita të Kuvendit të Komunës, pas shqyrtimit publik, të përcaktojë propozimin për miratim.

Neni 4

Mjetet për punën e Grupit Punues dhe shpenzimet tjera lidhur me ndryshimet dhe plotësimet në Statut, duke përfshirë edhe shtypjen e tekstit të spastruar, barten nga Buxheti i Komunës së Ulqinit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Fletoren Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunes".

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numri: 02-016/22-228-10
Ulqin, 29.07.2022

K R Y E T A R I,
Ardijan Mavriq, d.v.